

**RREGULLORE**  
**“PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT NË KOMISIONIN E PAVARUR**  
**TË KUALIFIKIMIT”**

**(Ndryshuar me vendimin nr.15, datë 7.3.2018; vendimin nr.22, datë 28.3.2018**  
**vendimin nr.31, datë 31.5.2018; vendimin nr. 53, datë 02.11.2018 të Mbledhjes së**  
**Komisionit të Pavarur të Kualifikimit)**

Në zbatim të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 13/d, 14/1, 14/2, 14/3 dhe 69/4 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Mbledhja e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit miraton këtë rregullore për procedurat që ndiqen për hedhjen e shortit gjatë veprimtarisë së këtij institucioni.

**Neni 1**  
**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt:

- a) Procedurat e shortit për ndarjen e trupave gjyquese;
- b) Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues;
- c) Procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjyquese, si dhe caktimin e anëtarit relator;
- d) Procedurat e shortit për caktimin e këshilltarit ligjor dhe ekonomik.

**Neni 2**  
**Parimet**

Kjo rregullore bazohet në parimin e transparencës, barazisë, efikasitetit, efikasitetit dhe objektivitetit.

**Neni 3**  
**Rregulla të përgjithshme**

1. Procedurat e shortit sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, realizohen në prani të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Kryetari i KPK –së drejton procedurat e shortit me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe në mungesë të tij, nga një punonjës i autorizuar nga Kryetari i KPK-së.
3. Për çdo rast të organizimit të shortit, Kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, njofton me shkrim ose me e-mail të gjithë anëtarët e Komisionit, jo më vonë se dy ditë pune përpara datës së hedhjes së shortit. Njoftimi përmban datën, orën, sallën e zhvillimit të shortit si dhe llojin e procedurës që do të përdoret, elektronike apo manuale.
4. Në çdo rast të hedhjes së shortit, Komisioni, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, njofton me shkrim dhe fton të marrin pjesë me cilësinë e vëzhguesit, anëtarët e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
5. Procedura e shortit sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, zhvillohet elektronikisht. Përjashtimisht, kur për arsye objektive shorti nuk mund të kryhet, (mungon sistemi elektronik ose ka defekte e pamundësi të plotë për funksionimin normal të tij), procedura e shortit do të zhvillohet në

mënyrë manuale. Në këtë rast, dokumentohet në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, arsyeja e zhvillimit të shortit në mënyrë manuale.

6. Në çdo rast, si për shortin elektronik, ashtu edhe për shortin manual, kryetari i Komisionit, me cilësinë e drejtuesit të shortit, garanton zbatimin e rregullave të parashikuara në këtë rregullore.
7. Në çdo rast, shorti hidhet në të njëjtën ditë, në të njëjtin mjedis për caktimin e anëtarëve të trupave gjyquese me nga tre anëtarë secili, për caktimin e anëtarit zëvendësues për çdo trupë gjyquese, për ndarjen e çështjeve që shortohen sipas trupës gjyquese, për caktimin e anëtarit relator si dhe për caktimin e këshilltarit ekonomik. Shorti për këshilltarin ligjor hidhet çdo 6 muaj. Çdo trupë gjyquese asistohet nga një sekretare gjyqësore, e cila përzgjidhet me short nga kryetari.
8. Procedurat për hedhjen e shortit zhvillohen në mjediset e punës ku zhvillon veprimtarinë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
9. Në çdo procedurë shorti, subjekti i rivlerësimit identifikohet me numrin rendor që mban në regjistrin e dosjeve, i cili administrohet nga Sekretari i Përgjithshëm.
10. Procedurat e shortit për rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit të përcaktuar në listën e përparësive për shkak të ligjit, do të zhvillohen brenda muajit nëntor 2017. Për datën e zhvillimit të shortit dhe numrin e subjekteve që do të shortohen, Komisioni shprehet me vendim të veçantë.
11. Të gjitha procedurat e shortit, përveç asaj të parashikuar në pikën 10 të këtij neni, duke filluar nga muaji janar i vitit 2018, do të zhvillohen çdo datë 15 të muajit që mban numër tek. Në rast se data 15 është ditë pushimi, shorti zhvillohet në ditën e parë pasardhëse të punës.  
11.1 Në rast të dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit, të cilët nuk janë shortuar ende në përputhje me këtë Rregullore, shqyrtimi i kërkesës do të bëhet nga një trupë gjyquese e përzgjedhur me short për një periudhë njëvjeçare nga data e hedhjes së shortit.
12. E gjithë procedura e shortit, në çdo rast, pasqyrohet në procesverbalin që mbahet nga sekretari i kryetarit të KPK-së dhe nënshkruhet nga të gjithë komisionerët e pranishëm. Në mungesë të sekretarit, procesverbali mbahet nga një person i autorizuar nga kryetari i KPK-së.

#### **Neni 4**

#### **Procedurat e shortit për ndarjen e trupave gjyquese**

1. Komisioni organizohet në katër trupa gjyquese të përbërë nga tre anëtarë.
2. Shorti për përcaktimin e tre anëtarëve të katër trupave gjyquese zhvillohet elektronikisht. Përjashtimisht, kur për arsye objektive shorti nuk mund të kryhet, (mungon sistemi elektronik ose ka defekte e pamundësi të plotë për funksionimin normal të tij), procedura e shortit do të zhvillohet në mënyrë manuale. Në këtë rast, dokumentohet në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim arsyeja e zhvillimit të shortit në mënyrë manuale.
3. Në rast të organizimit të shortit manual, emrat e të gjithë anëtarëve të Komisionit shkruhen në shirita të barabartë letre, me gërmë *arial 12*, verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit nga kryetari i Komisionit, i cili, pas verifikimit, i palos në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë të paktën nga tre komisionerë, përveç kryetarit, për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe ngrohtësi. Pas këtij verifikimi, Kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përziën, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.

4. Kryetari, me cilësinë e drejtuesit të shortit, përzgjedh në mënyrë rastësore tri gogla nga kutia transparente. Pasi i hap goglat një e nga një, lexon me zë të lartë emrat e tre komisionerëve, të cilët do të përbëjnë trupën e parë gjyquese.
5. E njëjta procedurë, me të njëjtën radhë veprimesh, do të kryhet edhe për përcaktimin e tri trupave të tjera gjyquese.
6. Në përfundim të kësaj faze të hedhjes së shortit, kryetari lexon edhe një herë me zë të lartë emrat e anëtarëve të çdo trupe gjyquese.
7. Pas ndarjes së trupave gjyquese, kryetari cakton me short edhe sekretaren gjyqësore për çdo trupë, që pasqyrohet në procesverbal dhe shënohet në regjistrin e dosjeve.

## **Neni 5**

### **Procedurat e shortit për caktimin e anëtarit zëvendësues**

1. Anëtari zëvendësues përcaktohet me short, për çdo trupë gjyquese, duke filluar nga trupa e parë e përzgjedhur, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje.
2. Shorti për caktimin e anëtarit zëvendësues zhvillohet elektronikisht. Përjashtimisht, kur për arsye objektive shorti nuk mund të kryhet, (mungon sistemi elektronik ose ka defekte e pamundësi të plotë për funksionimin normal të tij), procedura e shortit do të zhvillohet në mënyrë manuale. Në këtë rast, dokumentohet në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim arsyeja e zhvillimit të shortit në mënyrë manuale.
3. Në rast të organizimit të shortit manual, emrat e të gjithë komisionerëve, me përjashtim të anëtarëve të trupës gjyquese për të cilën shortohet anëtari zëvendësues, shkruhen në shirita të barabartë letre, me germë *arial 12*, verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit nga kryetari i Komisionit, i cili, pas verifikimit, i palos në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë të paktën nga tre komisionerë, përveç kryetarit, për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe ngrohtësi. Pas këtij verifikimi, kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përziën, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje. Kryetari përzgjedh në mënyrë rastësore vetëm njërin prej goglave në kutinë transparente, e hap dhe lexon me zë të lartë emrin e shkruar në shiritin e letrës. Ky emër është anëtari zëvendësues për këtë trupë gjyquese. Emri i anëtarit zëvendësues shënohet në regjistrin e dosjeve, përkrah përbërjes së trupës përkatëse.
4. E njëjta procedurë zbatohet edhe për caktimin e anëtarit zëvendësues në tri trupat e tjera gjyquese.
5. Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për sigurimin e kushteve të njëjta në çdo procedurë të hedhjes së shortit, sipas këtij neni.
6. Në përfundim të gjithë kësaj procedure, kryetari lexon me zë të lartë, edhe një herë, emrat e anëtarëve zëvendësues për çdo trupë gjyquese.
7. Për qëllim të shpërndarjes së punës në mënyrë proporcionale, anëtari zëvendësues i zgjedhur me short zëvendëson anëtarin e larguar të trupës në një çështje. Në rastet kur brenda një trupe ka nevojë për më shumë se një anëtar zëvendësues, anëtari/ët zëvendësues zgjidhen me short sipas çështjeve.

## Neni 6

### **Procedurat e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupat gjykuese, caktimin e anëtarit relator, kryesuesit të trupës dhe këshilltarit ligjor dhe ekonomik**

1. Shpërndarja e barabartë dhe rastësore e çështjeve në trupa gjykuese sigurohet nëpërmjet caktimit me short të anëtarit relator.
2. Të gjithë komisionerët do të jenë anëtarë relatorë në numër të barabartë çështjesh. Në këtë mënyrë sigurohet barazia e ndarjes së çështjeve edhe ndërmjet trupave gjykuese.
3. Caktimi i datës për ndarjen e çështjeve në trupa gjykuese dhe caktimin e anëtarit relator për subjektet e rivlerësimit të përcaktuar në listën e përparësive për shkak të ligjit, do të bëhet me vendim të Mbledhjes së Komisionerëve.
4. Përveç shortit të organizuar sipas pikës 10, të nenit 3, ndarja e çështjeve në trupa gjykuese dhe caktimi i anëtarit relator, sipas pikës 11, të nenit 3 të kësaj rregulloreje, do të jetë 3 çështje për çdo relator, në çdo procedurë shorti, për pasojë ndahen 9 çështje për çdo trupë gjykuese, duke garantuar kështu shortimin e të gjitha çështjeve (subjekteve të rivlerësimit) brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 179/b, pika 9 e Kushtetutës dhe nenit 70 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
5. Shorti për caktimin e anëtarit relator zhvillohet elektronikisht. Përjashtimisht, kur për arsye objektive shorti nuk mund të kryhet, (mungon sistemi elektronik ose ka defekte e pamundësi të plotë për funksionimin normal të tij), procedura e shortit do të zhvillohet në mënyrë manuale. Në këtë rast, dokumentohet në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim arsyeja e zhvillimit të shortit në mënyrë manuale.
6. Në çdo rast të organizimit të shortit, çdo subjekt rivlerësimi identifikohet me numrin rendor që ai mban në regjistrin e dosjeve, i cili administrohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Numrat e subjekteve të rivlerësimit që do të shortohen, shkruhen në shirita të barabartë letre, me gërmë *arial 12* dhe verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit nga kryetari i Komisionit. Kryetari, pas verifikimit, i palos në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë të paktën nga tre komisionerë, përveç kryetarit, për të verifikuar njëtrajshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe ngrohtësi. Pas këtij verifikimi, kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përzie, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
7. Me ndihmën e kryetarit, çdo komisioner, duke filluar nga numri 1 i listës së komisionerëve të renditur sipas rendit alfabetik, zgjedh 3 (tri) gogla, të cilat ia dorëzon kryetarit. Kryetari i hap goglat një e nga një, duke lexuar me zë të lartë numrin që gjendet në gogël. Ky numër, pasi regjistrohet në procesverbal, korrespondohet me emrin përkatës dhe regjistrohet në regjistrin e dosjeve. Në përfundim të kësaj procedure, pasi janë hapur të trija goglat, kryetari lexon edhe një herë me zë të lartë tre numrat dhe emrat përkatës të subjekteve të rivlerësimit, relator i çështjes së të cilëve do të jetë komisioneri që ka zgjedhur goglat. Goglat dhe shiritat e letrave me numrat përkatës, të përdorur në këtë fazë të shortit

administrohen nga Sekretari i Përgjithshëm, duke i përjashtuar nga shortimi i mëtejshëm. E njëjta procedurë ndiqet për të gjithë anëtarët e Komisionit. Në mungesë të ndonjërit nga anëtarët e komisionit, përzgjedhja e goglave bëhet nga kryetari i KPK-së në përfundim të përzgjedhjes nga anëtarët e pranishëm. Lista e subjekteve që do të shortohen sipas kësaj pike do të miratohet me vendim të Mbledhjes së Komisionit të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së hedhjes së shortit. Sekretari i Përgjithshëm kujdeset për sigurimin e kushteve të njëjta në çdo procedurë të hedhjes së shortit, sipas këtij neni.

8. Kryesuesi i trupës gjyqese zgjidhet midis dy anëtarëve të tjerë të trupës me dakordësi. Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi, kryesuesi zgjidhet me short, në momentin e caktimit të relatorit. Kjo procedurë pasqyrohet në procesverbal dhe në regjistrin e dosjeve.
9. Çdo komisioner relator do të ketë një këshilltar ligjor dhe një këshilltar ekonomik të përhershëm.
10. E gjithë procedura sipas këtij neni, pasqyrohet në procesverbal.

### **Neni 7** **Hyrja në fuqi**

1. Ky akt mund të ndryshohet me vendim të Mbledhjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga Mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Miratuar me Vendimin nr.10, datë 4.11.2017 të Mbledhjes së Komisionit të Kualifikimit.